

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Datë: 26.07.2021

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Nr: 04/02/2021


DISKUTIM PUBLIK ME QYTETARË

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Junikut, se me datë: **03.08.2021**, do të mbahet dëgjimi i dytë publik për Buxhetin e vitit 2022-2024. Takimi do të mbahet në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora **11:00**.

Ky takim është i rëndësisë së veçantë, pasi që do të merren propozimet nga qytetarët për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore komunale për vitet 2022/2024.

Pjesëmarrja, kontributi dhe sygjerimet tuaja do të jenë shumë të rëndësishme për proceset në vazhdim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!



Drejtoresha për Buxhet dhe Financa

Kosovare Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
Datë: 03.08.2021

Me rastin e mbajtjes së dëgjimit të II publik lidhur me buxhetin e vitit 2022- 2024 mbahet ky:

Procesverbal:

Të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës së Junikut, z. Agron Kuçi, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj. Kosovare Gacaferi, Drejtorë Komunal dhe qytetarë të Komunës së Junikut

Znj. Kosovare Gacaferi: Përshëndetje për ju Kryetar dhe për të gjithë juve të Pranishmit. Jemi këtu për të diskutuar lidhur me planifikimin e buxhetit për tri vitet e ardhshme, jemi në fazat fillestare të planifikimit të buxhetit, deri me 30 Shtator kemi afat kur duhet me e dorëzu KAB-in komunal final. Ende kemi pak kohë deri kur do ta pranojmë edhe qarkoren e dytë buxhetore nga Ministria e Financave. Në listën që e keni para jush mund të bëni propozime për projekte kapitale. Drejtoresha paraqiti grantet specifike nëpër drejtori të ndryshme, për vitin 2022 totali i buxhetit për Komunën e Junikut është paraparë të jetë 1,658,591.00Euro.

z. Agron Kuçi: ky është dëgjim publik sa i përket kornizës afatmesme buxhetore, buxheti final kalon në fund të muajit shtator. Unë kisha dashtë që të kemi propozime nga ju qytetarë të nderuar për propozime për projekte, në mënyrë që ti përfshijmë në listën e projekteve kapitale dhe ti bëjmë pjesë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022 2024. E hapim diskutimin.

Z.Agim Lllolluni: Kam një propozim për ndërtimin e pishinave verore.

z. Xhemë Gacaferi: Kërkoj që të ndërtohet shtylla të tensionit të lartë dhe të na largohen shtyllat nga tokat private.

z.Agron Kuçi: Faleminderit Agim për propozimin, komuna një ndër prioritetet kryesore e ka zhvillimin e turizmit, ne kemi konkuruar me projekt në Komisionin European për ndërtimin e pishinave të verës, ndërtimi i një restorantit të vogël ku mund të shërbeheni me pije të ftohta, akullore, kafe, dhe jemi në pritje. Ndërsa për propozimin e Xhemes për shtyllat elektrike të tensionit të lartë, dihet që ajo është kompani private dhe nuk po investon disa herë kemi bërë kërkesë zyrtare por nuk i marrin parasysh. Gjatë mandatit 4 vjeçar do ti fusim të gjitha shtyllat që janë në ajr ti instalojmë nëntokë, nuk besoj që KEDS investon por do ti gjejmë mjetet disi. Kemi aplikuar në GIZ dhe në Bankë botrore për një trafostacion.

z.Qytetari: Ku jemi me projektin e rrugës për bjeshkë?

z. Agron Kuçi: Kontrata është nënshkruar, është obligative dhe projekti do të vazhdojë. Ministria e Infrastrukturaes i ka ndaluar punimet, por rrugën Junik Gjeravicë nuk mundën me e ndalu, ajo do të vazhdojë.


z.Avdyl Gjota: Kam një kërkesë për parkingje, si ta bëni një zgjidhje sepse jemi bllokuar nga veturat?

Z.Agron Kuçi: Me të vërtetë propozim me vend, ne kemi bërë masterplanin për ndërtimin e komplet qendres dhe rregullimi i sheshit me disa student nga UBT, ku aty janë të parapara që rrugët për transportin e rëndë të zhvendosen dhe ti ndryshohet komplet pamja qytetit, por jemi duke pritur donacione.

Znj. Kosovare Gacaferi: nëse nuk ka dikush diçka tjetër, ju falenderoj për pjesëmarrje. Me kaq e shpalli të mbyllur këtë takim.


E përgatiti:

z. Ali Mataj



Miratoi: Drejtoreshë e Financave:

znj. Kosovare Gacaferi



Lista e propozimeve për projektet kapitale për vitet 2022-2024 nga qytetarët e Komunës së Junikut

Bexhep

Emri

Makaj

Mbiemri

Emri i Projektit	Viti i realizimit
Druga te Familja Maja my pertundin	2021
Letshime ne regjistrim te ferrive	2021

Lista e propozimeve për projektet kapitale për vitet 2022-2024 nga qytetarët e Komunës së Junikut


ARBNO R

Emri

KUQI

Mbiemri

Emri i Projektit	Viti i realizimit
KUQJA E DËSHAT SHTEPIVE	
KË RRJETIN E UJRAVE TE ZEZA	
NË LAGJEN ARASHA	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Datë: 03.08.2021

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

DISKUTIM PUBLIK PËR BUXHETIN 2022-2024

Nr.	EMRI, MBIEMRI	VENDI-KOMUNA	NR.TEL	EMAILI	NËNSHKRIMI
1	Selma Krasniqi	Junik			
2	HAKI KRASNIGI	JUNIK	+49 15901728818		
3	Miroci Xhafer	Junik			
4	Miroci Reçhap	Junik			
5	Miroci Hergjin	-			
6	Miroci Xhaferi	-			
7	Gzim Krasniqi	Junik			
8	Krasniqi Bylsy I	Junik			
9	Kosovane Gacajeri	JUNIK			
10	Artan Krasniqi	Junik			
11	Blerim Miroci	Junik			
12	Nurije Miroci	Junik			

